

Njoftim vendimi

Postuar në : 25/10/2023



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga Rezarta Schuetz kryesuese, Albana Shtylla relatores, Ina Rama, Natasha Mulaj, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 44/2021, datë 09.08.2021 që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Tomorr Kullolli, kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 396, datë 09.06.2021.

Në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 396, datë 09.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tomorr Kullolli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.10.2023.